Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Kujtim Bajrami	**14.04.2025**	**23.04.2025**	**2025/0234**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.04.2025, OE “Fabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/0234, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Elsam SHPK .”- Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “RIPARIMI I KUSHINETAVE TË DYFISHTA NË B1&B2 – TC “KOSOVA B”” me nr. të prokurimit: "KEK-24-10314-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a..

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur ;

Lloji i kontratës: pune

Vlera e parashikuar e kontratës: 350,000.00 €.

Publikimi i njoftimit për kontrate : 01.10.2024

Afati kohore për dorëzimin e ofertave : 05.11.2024 ,ora : 12:00

Publikimi I njoftimit mbi vendimin e AK-s : 18.03.2025

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1- Qellimi i Ligjit Nr. 04/L-042

Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 59 , Paragrafi nr 4 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

Pika e pare eleminimit ka te beje me certifikaten 1090 ku eshte e vertete qe ne kemi bere kerkese per sqarim edhe ne dosjen e tenderit sepse ne mendojme qe Certifikata ne fjale nuk eshte e rendesise primare per tenderin ne fjale sepse siç dihet Kjo certifikate ka te beje me konstruksione çeliku dhe alumini ne sektorin e ndertimit , e cila kerkohet nga Bashkimi Evropian per konstruksionet e exportuara ne Evrope ,mirepo duke u nisur nga- fakti qe riparimi i kushinetave te dyfishta ne Termocentralet e KEK sha eshte e nje rendesie shume te madhe per juve si kompani dhe duke u nisur nga fakti qe interesi i kompanise eshte qe ky projekt te realizohet duke mos u demtuar edhe buxheti , ne mendojme se mungesa e kesaj certifikate si e rendesise sekondare nuk duhet te jete arsye per eleminim , shtuar kesaj edhe pervojen e kompanise tone per realizimin e projekteve te ngjashme dhe kontratat e realizuara per projektin ne fjale me heret me Kompanine tuaj. Ne si kompanie posedojme te gjitha standardet tjera te kerkuara siç jane ISO 9001-2025 , ISO 14001 , ISO 45001 dhe ne veçanti standardin ISO 3834-2 i cili perfshine ne vete edhe ISO 1090 si pjese te saj per procedurat e saldimit , andaj kerkojme ana juaj qe te keni ne konsiderate kerkesen tone per rishqyrtim te vendimit tuaj per eleminim.

Pika e dyte : Certifikatat e salduesve.

Sic mund te shihet ne dokumentaticionin e ofruar, Certifikatat e prezantuara nga ana jone jane valide deri me date 23.11.2025 , mirepo per aryse teknike ka ndodhur nje gabim gjate bashkangjitjes ne platforme te certifikatave sepse ne gabimisht i kemi bashkangjitur certifikatat e vjetra dhe jo ato te plotesuarat pasi qe ne si kompani kemi kryer te gjitha procedurat e nevojshme sipas standardit nga Kordinatori yne i kontraktuar z Jeton Gashi i diplomuar dhe person i autorizuar per te kryer kontrollet e nevojshme sipas standardit ISO 3834-2 . Ne per te argumentuar kete qe po themi do te ju bashkangjesim Certifikatat e salduesve te plotesuara ne piken 9.2 dhe 9.3b te standardit si dhe kontraten e nenshkruar me Kordinatorin. Ne mendojme se kemi te bejme me shkelje te nenit 72 te ligjit te prokurimit sepse neve per piken ne fjale nuk na eshte kerkuar nga Autoriteti Kontraktues deshmi shtese ose kerkese per sqarim lidhur me kete mos validitim ne certifikatat tona.

Pika e trete -Referenca

Ne si operator ekonomik kerkojme nga Autoriteti kontraktues te shqyrtoje edhe njeher dosjen tone per tenderin e larte cekur pasi qe pretendojme se ne i kemi plotesuar te gjitha kushtet ligjore per te qene tenderues i pergjegjshem ne kete aktivitet.

Argumentet tona lidhen me faktin se ne me dosjen tenderit kemi dorezuar referenca te mjaftueshme qe plotesojne ngjajshmerine identike me punen dhe riparimin qe kerkohet ne kete dosje te tenderit. Ne ne vitet paraprake kemi realizaur kontraten nr :919- datë 14.05.2014 te cilen e kemi me juve si kontraktorë kemi deshmuar se kemi kapacitete teknike dhe profesionale per prodhimin e(4 copë) Boshteve te reja per kushinetat e dyfishta me numra si vijon : 23284K si dhe 23252K te cilat deshmojne se jane identike

me kushinetat e kerkuara ne Dosjen per Riparimin e kushinetave te dyfishta te larte cekur.

Gjithashtu ne kemi realizuar edhe projektin e njejte (Riparimi i kushinetave te dyfishta) me nr kontrate 2470 i dates 29.11.2016 dhe projekti i realizuar sipas kontrates nr 2593 (Furnizimi me pjese rezerve per kushineten e dyfishte) i dates 04.04.2018 . Kjo tregon se ekzistojne kapacitet tona edhe per riparim te kushinetave te cilat jane kerkuar ne kete dosje tenderi te lartë cekur., mirepo pasi qe ne dosjen e tenderit eshte cekur qe referenca te jete me e re se tri vite ne nuk kemi pasur mundesi qe te ju prezantojme keto kontrata si dokumente reference per arsye te periudhes kohore.

Pika 4-Standartet e dyfishta qe pretendojme se jemi eleminuar pa drejtesisht eshte se jane perdorur standarde te dyfishta ne kete tender nga Autoritetit kontraktues pasi qe i njejti ka bere shpalljen e tenderit per Riparim te kushinetave te dyfishta edhe ne termocentralin Kosova A me date 18.12.2024 me nr prokurimi : KEK-24-13346-5-2-1 / KEKC-24-418-521 dhe titullt : Riparimi komplet i kushinetave të dyfishtë për mullinj te njësisë A3 - A5 ,dhe ne dosjen e tenderit ne fjale nuk eshte kerkuar Certifikata ISO 1090 si dhe nuk jane kerkuar as certifikata te salduesve dhe as CV dhe diploma te stafit , kurse ne tenderin ne TCB po . Mendojme qe eshte pergaditje paraprake dhe kushte te caktuara me qellime per te percaktuar operatorin ekonomik fitues paraprakisht per te eleminuar konkurencen me kerkesa jo relevante per tenderin ne fjale, sepse Certifikata e kerkuar ISO 1090 eshte nje certifikate qe ju jepet Kompanive te specializuara ne fushen e konstruksioneve te çelikut ne ndertim ,nese ju jeni te interesuar per te vertetuar te gjitha keto ju mund te kerkoni informata shtese edhe ne internet dhe aty mund te gjeni te gjitha fushat qe i mbulon ky standard, prandaj kjo Certifikate nuk ka asgje te perbashket me industrine mekanike , konkretisht me riparimin e kushinetave te dyfishta , shtepizave dhe boshteve te kushinetave. Kete fushe me se miri e mbulon ISo Standardi 3834 si dhe certifikimet e salduesve te cilet jane pjese e ketij standardi.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**apaciteti teknik dhe professional:** **1. Projektet e realizuara brenda 3 viteve te fundit;** **2. Kualifikimet profesionale dhe edukative të stafit menaxherial** **• Se paku (3) tre Saldues te certifikuar sipas standardit EN ISO 9606-1 •Se paku 10 punëtorë me shkolle te mesme** **• Së paku (1) një inxhinier të diplomuar të makinerisë, me pervoje pune**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1 . Një liste te aktiviteteve të ngjashme të OE qe specifikon punët e kryera, shumën e kontraktuar, datën dhe pranuesin, si dhe duhet te prezantoje referencë apo certifikatë mbi përfundimin apo ekzekutimin e punëve nga punëdhënësi te projekteve me një fushëveprim te ngjashëm për (3) tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, me kontaktet për verifikim, nga ku mund të shihet kapaciteti teknik dhe përvoja e tij.**

		minimum 5 vite **3. Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet** **OE duhet te dëshmojë se është i certifikuar me ISO 9001 2015, ISO 14001, ISO 45001, ISO 1090 dhe EN ISO 3834-2.**	**2. Operatori ekonomik ne ofertën e vet teknike duhet te prezantoj stafin i cili do ti realizoj punët sipas kërkesave. Me hollësisht nga operatori ekonomik kërkohet qe ne ofertën e tij ta prezantoj • Lidhur me (3) tre Salduesit e certifikuar sipas standardit EN ISO 9606-1, te dëshmohet me certifikate, kontrate pune apo para kontrate.** **• Lidhur me 10 punëtorët, te dëshmohet me CV, kopje te diplomës se shkollës se mesme dhe kontrate pune apo para kontrate.** **• Lidhur me inxhinierin e diplomuar të makinerisë, të dëshmohet me CV, kopje të diplomës dhe kontratë pune ose para kontrate.** **3. Lidhur me certifikimin OE duhet te prezantoj kopjen e certifikatës ISO 9001 2015, ISO 14001, ISO 45001, ISO 1090 dhe EN ISO 3834-2.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË E AFTËSIVE PROFESIONALE TË TENDERËVE

Dokumenti	"ELSAM"SHPK	Grup i Operatorëve Ekonomik EKSIM COM SH.P.K.; Termo Oprema	Fabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K.
	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim
1. Projektet e realizuara brenda 3 viteve te fundit; 2. Kualifikimet profesionale dhe edukative të stafit menaxherial • Se paku (3) tre Saldues te certifikuar sipas standardit EN ISO 9606-1 • Se paku 10 punëtorë me shkolle te mesme • Së paku (1) një inxhinier të diplomuar të makinerisë 3. Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet OE duhet te dëshmojë se është i certifikuar me ISO 9001 2015, ISO 14001, ISO 45001, ISO 1090 dhe EN ISO 3834-2.	Në pajtim	I papajtueshëm	I papajtueshëm

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues është palë me interes sipas nenit 4.1.26 të LPP-së

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Fabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K.**

Në cilësinë e ekspertit shqyrtues të prokurimit publik, pas analizës së ankesës së Operatorit Ekonomik "Fabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K." në lidhje me aktivitetin e prokurimit KEK-24-10314-5-2-1, konstatohet si më poshtë:

Pretendimit ankimor - **Pika 1 – Mungesa e Certifikatës EN ISO 1090**

Ne këtë pretendim ankimore OE pranon mungesën e certifikatës EN ISO 1090, por pretendon se ajo nuk është relevante për natyrën e punës (riparim mekanik, jo konstruksione çeliku). Thekson përvojën me projekte të ngjashme dhe posedimin e certifikatave tjera relevante (ISO 9001, 14001, 45001, 3834-2), duke kërkuar që mungesa e ISO 1090 të mos jetë arsye për eliminim.

Përgjigje ne pretendimin ankimor 1- Eksperti shqyrtues ka analizuar në mënyrë të hollësishme pretendimin ankimor dhe ka vlerësuar kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë nga ana e Autoritetit Kontraktues. Nga shqyrtimi rezulton se **Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me nenin 59 të LPP-së**, kur ka konstatuar se **mosdorëzimi i certifikatës EN ISO 1090 përbën mosplotësim të kërkesave të kualifikimit**, ashtu siç ishin të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate.

Pavarësisht vlerësimit subjektiv të OE-së për rëndësinë e kësaj certifikate, ajo ka qenë **kriter i qartë, objektiv dhe i detyrueshëm** për të gjithë operatorët ekonomikë.

Prandaj, eliminimi i OE-së është bërë në mënyrë të drejtë dhe ligjore dhe ne këtë pikë pretendim

ankimor është i pa bazuar .

Pretendimit ankimor - **Pika 2** Certifikatat e pavlefshme të salduesve

Ne këtë pretendim ankimor OE ankuese pretendon se Certifikatat e prezantuara nga ana jone jane valide deri me date 23.11.2025 , mirëpo për arsye teknike ka ndodhur një gabim gjate bashkëngjitjes ne platforme te certifikatave sepse ne gabimisht i kemi bashkangjitur certifikatat e vjetra dhe jo ato te plotësuarat pasi qe ne si kompani kemi kryer te gjitha procedurat e nevojshme sipas standardit nga Koordinatori ynë i kontraktuar z Jeton Gashi I diplomuar dhe person i autorizuar për te kryer kontrollet e nevojshme sipas standardit ISO3834-2. OE ankues pretendon se AK-ja ka bere shkelje te nenit 72 te ligjit te prokurimit pasi qe për piken ne fjale nuk ka dëshmi shtese ose kërkesë për sqarim lidhur me validitetin ne certifikatat tona.

Përgjigje ne pretendimin ankimor 2- Eksperti shqyrtues ka analizuar në mënyrë të hollësishme pretendimin ankimor dhe ka vlerësuar kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë nga ana e Autoritetit Kontraktues. Nga shqyrtimi rezulton se **Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me nenin 59 të LPP-së ,**pasi qe dorëzimi i dokumenteve të pasakta, përfshirë certifikata të skaduara apo të papërshtatshme, është përgjegjësi e plotë e OE-së. Gabimet teknike nuk e përjashtojnë këtë përgjegjësi. Autoriteti Kontraktues nuk ka qenë i obliguar të kërkojë sqarime shtesë për dokumente jo të rregullta. AK ka vepruar në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së. **Prandaj, pretendimi konsiderohet i pabazuar.**

Pretendimi ankimor – Pika 3: Referencat më të vjetra se 3 vite nga data e publikimit te njoftimit për kontratë .

Në këtë pretendim, OE ankues kërkon që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë dosjen e tij, duke theksuar se posedon përvojë relevante dhe kapacitete të mjaftueshme teknike e profesionale për realizimin e kontratës. Megjithëse vetë pranon se nuk ka paraqitur referenca brenda afatit kohor prej 3 vitesh, siç kërkohet në dosjen e tenderit, OE thekson se ka realizuar projekte të ngjashme më parë – në vitet 2014, 2016 dhe 2018 – të cilat, sipas tij, dëshmojnë aftësinë për riparimin e kushinetave të dyfishta, të kërkuara në këtë aktivitet.

Përgjigje ne pretendimin ankimor 3- Eksperti shqyrtues ka vlerësuar pretendimin dhe dokumentacionin përkatës dhe konstaton se OE ankues nuk ka dorëzuar referenca brenda periudhës së kërkuar prej tre (3) viteve, siç është përcaktuar qartë në Dosjen e Tenderit. Edhe pse OE pretendon se përvojat më të vjetra (nga vitet 2014, 2016 dhe 2018) janë të ngjashme dhe dëshmojnë kapacitetet e tij, neni 69.6.2 i Ligjit për Prokurimin Publik i jep Autoritetit Kontraktues të drejtën të kërkojë referenca brenda një periudhe të caktuar kohore.

Meqë ky kufizim ka qenë i përcaktuar në dokumentacionin e tenderit dhe zbatohet njësoj për të gjithë ofertuesit, mosplotësimi i tij përbën mos përmbushje të kërkesave esenciale të tenderit. **Prandaj, pretendimi konsiderohet i pabazuar**.

Pretendimi ankimor – Pika 4: Standardet e dyfishta

Ne këtë pretendim ankimor OE ankues pretendon se është eliminuar padrejtësisht për shkak të përdorimit të standardeve të dyfishta nga Autoriteti Kontraktues. Si argument, theksohet se në një tender të ngjashëm të shpallur më 18.12.2024 për termocentralin Kosova A, nuk janë kërkuar as certifikata ISO 1090, as certifikata të salduesve, CV apo diploma të stafit – ndërsa në tenderin aktual të TCB-së, këto janë kërkuar. OE konsideron se kjo përbën favorizim dhe kufizim të konkurrencës, duke vendosur kritere jo relevante, pasi ISO 1090 lidhet me konstruksione çeliku në ndërtimtari, jo me industrinë mekanike apo riparimin e kushinetave. Sipas tyre, standardi përkatës në këtë rast do të ishte ISO 3834 dhe certifikimet për salduesit.

Përgjigje në pretendimin ankimor – Pika 4: Standardet e dyfishta

Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin dhe dokumentacionin përkatës dhe konstaton se çdo aktivitet prokurimi trajtohet në mënyrë të veçantë, me kërkesa teknike që përcaktohen në përputhje me natyrën dhe rëndësinë e projektit. Prandaj, fakti që në një tender tjetër nuk janë kërkuar certifikata të caktuara, nuk e bën të vlefshëm pretendimin për trajtim të pabarabartë në këtë rast specifik.

Gjithashtu, sipas Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores për Prokurimin Publik, janë përcaktuar qartë afatet dhe format për paraqitjen e kërkesave për rishqyrtim ose ankesave, në rastet kur operatorët ekonomikë konsiderojnë se Autoriteti Kontraktues ka vendosur kushte diskriminuese, favorizuese ose jo proporcionale me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Nëse një operator nuk ka ushtruar të drejtën e tij brenda këtyre afateve ligjore, pretendimet e mëvonshme nuk mund të konsiderohen të bazuara. **Prandaj, pretendimi konsiderohet i pabazuar.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Fabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K.**

Kujtim Bajrami